



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

**VENDIM**  
**Nr. 51, datë 6.10.2021**

**PËR**  
**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E**  
**SISTEMIT TË KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL – AECH”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH”, miratuar me vendimin nr. 35, datë 3.6.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a. Neni 38 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

**“Neni 38**  
**Begatimi pa shkak**

1. *Një pjesëmarrës përfitues, është subjekt i një pretendimi për begatim pa shkak nga një pjesëmarrës urdhërues:*
  - a) *nëse përfituesi nuk krediton llogarinë e klientit dhe të bëjë të disponueshme fondet brenda së njëjtës datëvalute kur instruksionet e pagesës janë të sakta;*
  - b) *nëse përfituesi nuk kthen/kompenson brenda afateve të përcaktuara më poshtë fondet të cilat nuk është në gjendje t'i transferojë në llogarinë e klientit të tij, për shkak të:*
    - i. *detajeve të pasakta ose kontradiktore të llogarisë dhe/ose,*
    - ii. *mbylljes së llogarisë për të cilën janë destinuar këto fonde.*
2. *Përfituesi kryen kompensimin e pagesës së parashikuar në pikën 1/b) të këtij neni tek urdhëruesi brenda 5 (pesë) ditësh pune nga datëvaluta e pagesës fillestare.*
3. *Kompensimi i pagesës realizohet nëpërmjet inicimit të një urdhërpagese nga përfituesi, subjekt i pretendimit për begatim pa shkak, në drejtim të urdhëruesit, për vlerën e pagesës fillestare, duke zbritur komisionin e*

*pjesëmarrësit të begatuar pa shkak dhe tarifën e përcaktuar për përdorimin e sistemit, sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.*

- 4. Për çdo ditë vonesë në kthimin e fondeve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, përfituesi sanksionohet nga urdhëruesi, i cili pretendon begatim pa shkak të përfituesit me normën repo 1-javore + 2 pikë përqindje.*
  - 5. Mosshlyerja e detyrimeve nga përfituesi, subjekt i pretendimit për begatimit pa shkak, në shumën dhe afatet e përcaktuara në këtë nen, përbën shkelje të kësaj rregulloreje.”*
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes.
  3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**